



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 103  
Prishtinë, më 25.6.2024, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Hajdar Beqa, Halil Thaqi, Visar Korencia, Rashit Qalaj, Yllëza Hoti.

Munguan: Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Albana Bytyqi, Bekim Arifi dhe Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Hana Bajraktari, Fatbardha Boletini.

Pjesëmarrësit e tjerë: Driada Thaqi, nga ZKA, Erona Retkoceri, praktikante në Kuvend.  
Mbledhjen e kryesoi: Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim lidhur me rekomandimet e raporteve të shqyrtuara në komision;
3. Të ndryshme.

**Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Diskutim lidhur me rekomandimet e raporteve të shqyrtuara në komision.**

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Të nderuar të pranishëm, ne si komision e kemi ftuar ministren Nagavci për sot, por e kemi marrë një përgjigje me vonesë. Andaj kam kërkuar që mbledhja të mbetet, në mënyrë që t'i nxjerrim përfundimet për raportet e shqyrtuara deri tani.

**Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit:** Vetëm për sqarim, pasi kemi qenë të përfshira në e-mail, dje jemi njoftuar që personat që janë përfshi në e-mail, nuk janë më pjesë e kabinetit të ministres. Po ashtu, që ministria është në udhëtim zyrtar, andaj duhet të bëjmë përpjekje ta ftojme për takimin e radhës.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Si komision kemi shqyrtuar disa raporte, por që në fund të takimeve kemi mbetur pa kuorum, andaj edhe kanë mbetur pa u vendosur për adresimin e tyre. Po fillojmë nga raporti i fundit që e patëm në shqyrtim. Duhet të vendosim, që raporti me rekomandime konkrete të adresohet për në seancë plenare, apo që ky raport të mbetet në nivel të komisionit, por vetëm njoftohen komisionet përkatëse, siç kërkohet me rregulloren e Kuvendit, që e kemi shqyrtuar dhe nuk kemi rekomandime shtesë.

**Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit:** Ne nuk e konsiderojmë që kemi rekomandime dhe arsye për ta dërgua për shqyrtim në seancë.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** A ka propozime tjera për këtë raport?

### *Përfundim*

*KMFP-ja vendosi që, Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2023, të mos adresohet në seancë plenare për shqyrtim, por vetëm të njoftohen komisionet përkatëse, siç kërkohet me rregulloren e Kuvendit.*

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Raport tjetër i mbetur pa përfundim është: Raporti i auditimit të Performancës: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”; do të adresohet për në seancë plenare, bashkë me rekomandimet e propozuara nga komisioni, apo do të mbetet në nivel të komisionit. Deputete raportuese ka qenë Albana Bytyqi. Nuk e ka propozua për seancë dhe nuk kemi rekomandime. Nëse s’ka propozime të tjera, atëherë edhe ky raport le të mbetet në nivel të komisionit.

### *Përfundim*

*KMFP-ja vendosi që, Raporti i Auditimit të Performancës: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”, të mbetet në nivel të komisionit.*

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Si komision po ashtu, kemi shqyrtuar edhe Raportin e auditimit të performancës “Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjellësit Rajonal

Prishtina”. Deputetja raportuese nuk e ka propozuar për shqyrtim në seancë. Nëse s’keni propozime të tjera.

#### *Përfundim*

*KMFP-ja vendosi, që Raporti i Auditimit të Performancës: “Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjetës Rajonal Prishtina” të mbetet në nivel të komisionit.*

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Si komision duhet ta dërgojmë një rekomandim në seancë, për miratim ose mosmiratim, të Raportit vjetor të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023. Për këtë raport komisioni mund të ketë edhe rekomandime të tjera për ZKA-në. Ka mbetur të votohet.

**Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit:** Pasi që nuk kemi propozim rekomandime shtesë, atëherë duhet ta dërgojmë vetëm një rekomandim për votim ose mosmiratim.

#### *Përfundim*

*KMPF-ja miratoi raportin vjetor të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023, bashkë me pasqyrat financiare të audituara. Të njëjtin do ta përcjellë në seancë për shqyrtim dhe miratim.*

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Po ashtu, pa përfundim e kemi edhe Raportin e auditimit të performancës “Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”. Deputete raportuese ka qenë Mirlinda Tishukaj- Sadiku, e cila ka propozua edhe disa rekomandime. Por pasi që ky raport ka arriti me mjaft gjetje, e kemi pa edhe gjatë shqyrtimit. Ku s’ka as koordinim mes MKRS-së dhe ATK-së, ku këtë, një numër i bizneseve këto munden mi shfrytëzua si alibi për evazion fiskal. Nëse pajtoheni, këtë raport po e shtyjmë për një takim të radhës, duke pasur parasysh që edhe janë në plotësim ndryshim të ligjit, rekomandimet tona mund t’ju ndihmojnë institucioneve.

**Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit:** Pasi që edhe deputetja raportuese e ka propozuar, që ky raport të shkojë për shqyrtim në seancë bashkë me rekomandime, pajtohem që ky raport të shtyhet për një mbledhje të radhës.

### **3. Të ndryshme**

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Nëse s’kemi diçka tjetër, a po mbetet që për mbledhjen e radhës ta ftojme edhe njëherë ministren e MASHT-it.

**Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit:** Po pajtohem, por propozoj gjithashtu që të mbetet si opsion edhe një raport tjetër nëse nuk vjen ministrja.

**Hajdar Beqa:** Unë propozoj t'i kemi në shqyrtim disa raporte, sepse edhe ashtu jemi në përfundim të sesionit, dhe kemi fillua me shkua në periudhën kryesore të punës me pushu seancat. Nuk ka pasur kësi precedenti në të kaluarën, që në kohë të punës me shkua me renovim.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Si komision, nuk kemi pasur mundësi të shqyrtojmë shumë raporte, sepse tani kemi fillua t'i kemi raportet, andaj edhe mund të propozoni ato që i konsideroni si të rëndësishme

**Yllza Hoti:** Unë kisha propozua që nëse nuk vjen ministrja, ta kemi në shqyrtim, raportin e auditimit të performancës, Menaxhimi i licencimeve në Komisionin e Pavarur të Mediave.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Hykmete Bajrami,

---

Kryetare e Komisionit